

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	214-22-12927-1-1-1
Nr i brendshëm	214-22-121-1-1-1

Sa i përket tenderit për: “Furnizim me targa për regjistrimin e automjeteve”.

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

EGO ELSA SH.P.K. & RADE KONCAR -KONTAKTORI I RELEI DOO SKOPJE
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Llapllasellë, Rruga e Pejes, p.n-Graçanicë

(Adresa)

Graçanicë

10 500

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349230122

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Egon Hoti

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Egoelsa.shpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

29.03.2023

(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 08.12.2022
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 20.01.2023
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 09.03.2023
Kërkesa për rishqyrtim: 14.03.2023
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt:21.03.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 43.5 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 43.7 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Shpallja e tenderit është publikuar me dt.08.12.2022.

Kontratë për furnizim, vlerë e madhe, procedurë e hapur

Gjatë fazës së tenderimit ka pasur pyetje sqaruese.

Hapja e ofertave është bërë me dt.20.01.2023, ku kanë ofertuar gjithsejtë nëntë operator ekonomik. Kompania Ego Elsa Shpk:Rade Koncar është eliminuar me vetëm një arsye dhe atë shumë të paqëndrueshme, ndërsa arsyeja e eliminimit është e bartur më poshtë dhe e marr nga letra standarde për tenderues të eliminuar:

3.Nuk e keni paraqitur – dorëzuar mostrat e targave në përputhshmëri me specifikimet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe sqarimeve të dt.05.01.2023.

Komisioni i vlerësimit me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit lidhur me përshtatshmërinë teknike, duke u bazuar në raportin - ekspertizën e laboratorit të Forenzikës – me nr. ref. AFK/2023-028 i dt.28.02.2023, ka konstatuar se mostra me shifër (444) e dorëzuar nga ky ofertues nuk e përmbushin kërkesat sipas specifikimeve teknike dhe sqarimeve të dt.05.01.2023.

Të paraqitura gjeni në tabelë më poshtë pikat të cilat nuk janë të përmbushura për OE në fjalë:

Kërkesa sipas specifikimit teknik në dosjes së tenderit		Verifikimi i mostrës nga Laboratori i Forenzikës
1.Trashësia e Materialit Bazë	1 mm me tolerancë ± 0.03	1.169mm

Një arsye e tillë e eliminimit është shumë joserioze, e pabazuar në ligj, në dosje të tenderit, dhe e pa argumentuar nga ana e autoritetit kontraktues.

Mostrën që ne e kemi ofruar është në harmoni të plotë me kërkesat e specifikacionit teknik, e po ashtu edhe trashësia nuk ka asnjë mundësi të jetë ashtu siç pretendon AK-ja me trashësi **1.169 mm**.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentacion (disa dokumente të operatorëve ekonomik nuk na janë dhënë nga AK-ja) dhe gjatë qasjes e kemi vërejtur se asnjë nga mostrat që i kemi pa nuk janë deformuar apo dëmtuar, andaj nga ky fakt ne si profesionist të kësaj fushe, kemi ardhur në një konkludim se mostra e dërguar në forenzikë për testim nuk është testuar dhe matur ashtu siç është dashur.

Nga këto analiza dhe faktet që i kemi shikuar, shihet se mostra është matur së bashku me materialin reflektues-foli, prandaj ka rezultuar trashësia e materialit të jetë më e madhe.

Nëse do të ishte matur mostra vetëm me materialin bazë ashtu siç e ka përcaktuar vet AK-ja se si duhet të matet, normalisht që mostra do të ishte me trashësi prej 1mm ± 0.03 mm, e jo siç është shënuar nga ana e autoritetit kontraktues se trashësia është 1.169 mm.

Tek specifikimi teknik në dosje të tenderit është specifikuar qartë:

Specifikimi detal për furnizim me targa të Republikës së Kosovës.

1. Materiali bazë

1.1 Alumin 1 mm i trashë Toleranca ± 0.03 mm

EN 1396:2007 Vetitë mekanike për shtresën.

Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42 Shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.

Duke pasur për bazë këtë specifikim dhe këtë kërkesë, ne kemi ofertuar dhe kemi ofruar mostrën pikërisht në harmoni me këtë specifikim detal (alumin 1 mm i trashë me tolerancë ± 0.03 mm),

prandaj arsyeja e eliminimit është më të vërtetë joprofesionale dhe e pa argumentuar. Ky lëshim i AK-së që ka ndodhur duhet të korrigjohet dhe të matet edhe njëherë mostra por normalisht vetëm materiali bazë e jo me gjithë materialin reflektues-foli.

Ne me dosje të tenderit e kemi bashkangjitur test raportin nga laborator i akredituar DEKRA dhe test certifikatën të cilat janë në përputhje me standardin ISO 7591, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Me këto certifikata dhe me test raport është konstatuar dhe vërtetuar se materiali bazë alumin EN AW-1050 H42 ka trashësi 1 mm.

Bashkangjitur keni edhe njëherë këto dy dokumente.

Autoriteti kontraktues nuk i është përmbajtur kërkesave të përcaktuara tek specifikimet teknike pasi që, nga raporti i forenzikës vërtetohet fakti se nuk është matur vetëm materiali bazë (alumini) ashtu siç është dashur të veprohej por është mat me materialin reflektues. Autoriteti kontraktues e ka pasur për obligim ti tregoj forenzikës se cili material duhet të matet e jo të bëhen këto lëshime joprofesionale, sepse sipas specifikimeve teknike materiali reflektues-foli ka qenë kërkesë e veçantë.

Bazuar në këto matje jo të sakta, propozojmë që matjet të përsëriten ose të bëhen nga një laborator tjetër profesional vendor ose ndërkombëtar.

Po ashtu kërkojmë nga OSHP-ja që të mbahet edhe seancë dëgjimore dhe të prezantohen mostrat e secilit operator ekonomik, e ku ne do ti elaborojmë çështjet në lidhje me mostrën tonë dhe do të argumentojmë se mostra jonë është në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikat e kërkuara. Po ashtu ne, në seancë do të përfaqësohemi me ekspertin për prodhimin e tabelave-inxhinierin e makinerisë z. Goran Zdravkovski.

Në këtë procedurë të prokurimit, ne jemi diskriminuar sepse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, specifikimet teknike dhe është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi, pasi që të gjithë operatorët ekonomik më të lirë se ne, janë të papërgjegjshëm.

Grupi i OE Eich Utsch AG; Horn & Co Kosova SHPK, janë të papërgjegjshëm për faktin se të njëjtit nuk e kanë plotësuar kërkesën në lidhje me test raportin nga laborator apo instituti i autorizuar. Grupi i OE të lartcekur nuk e plotëson këtë kërkesë ashtu siç ka konstatuar edhe AK-ja:

Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një test laborator me numër 0628/1895266884/21 nga Dekra, ky test raport nuk ka të evidentuar që janë bërë matjet (testimi) për mostrën 01-999-AD siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023, gjithashtu në test raport nuk ka rezultatet pozitive kërkesat në pikën 10 të aneksit 1 të dosjes të tenderit, andaj ky test raport nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023.

OE ne fjalë ka prezantuar një Technical Specification nga KURZ por nuk kemi as një dëshmi që KURZ është Laborator apo institut i akredituar për matje (testim) siç është kërkuar në dosje të tenderit (sipas verifikimeve në internet Kurz nuk figuron që është Laborator apo institut i akredituar për matje).

Pra ne pajtohemi me arsyen e lartcekur për eliminimin e grupit të operatorëve ekonomik të lartcekur, pasi që të njëjtit janë të papërgjegjshëm.

OE "EUROPRINTY", është i papërgjegjshëm administrativisht dhe ne pajtohemi me arsyet e dhëna nga AK-ja për eliminimin e të njëjtit ku e ka cekur se:

Ju për këtë kërkesë nuk keni dozuar fare një mostër të targës siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023.

2. OE pjesëmarrës duhet të depozitoj Sigurimit të Tenderit në shumën: 75,000.00 € për periudhë valide prej 120 ditë.

Ju për këtë kërkesë nuk keni dorëzuar fare dëshmi sigurimin të tenderit.

OE “IDK KONSTRUKSION SHPK”, është po ashtu operator ekonomik i përgjegjshëm pasi që edhe ky OE nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar *“Test Raport nga Laboratori apo instituti i autorizuar i cili, duhet të dëshmojë që prodhimi i targave (mostrave) për regjistrim të automjeteve dhe karakteristikat teknike të targave janë në përputhje me standardet ISO 7591 dhe specifikimeve teknike të dosjes së tenderit”*.

Sa i përket kërkesës së lartcekur të cilën OE nuk e ka përmbushur, ne pajtohemi me arsyen që AK-ja e ka dhënë për eliminimin e të njëjtit, ku e ka cekur se:

1. Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një test report me nr. AQS/12122022 ku ka kryer matjet (testime) siç janë kërkuar në doje të tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023, mirë po të certifikata e akreditimit të lëshuar nga drejtoria e përgjithshme e Akreditimit të Shqipërisë nuk ka ndonjë dëshmi që AQSCERT-SHPK, është i akredituar të bëjë matjet (testimet) sipas standardit ISO 7591, pas hulumtimit në

internet të Web faqja e AQSCERT-SHPK kemi gjetur dëshmi që e njëjta është e akredituar për ISO standarde tjera por jo edhe për ISO 7591.

OE “CETKOS L.L.C; Utal Spz.o.o”, është i përgjegjshëm pasi që edhe ky OE sikurse operatori i lartcekur nuk e plotëson kërkesën në lidhje me Test raportin nga laboratori apo instituti i autorizuar. AK-ja tek letra standarde për tenderues të eliminuar e ka cekur si në vijim:

1. Ju për këtë kërkesë ka prezantuar një test report me numër ZBH/23/0068 nga MOTOR TRANSPORT INSTITUTE, ky test raport nuk ka të evidentuar që janë bërë matjet (testimi) për mostrën 01-999-AD siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023, gjithashtu në test raport nuk ka rezultatet pozitive sipas kërkesave të pika 10 e aneksit 1 të dosjes së tenderit.
Çdo dokument tjetër i dorëzuar që nuk është nga laboratori i akredituar nuk pranohej.

Andaj ne pajtohemi me arsyen e lartcekur të AK-së, për eliminimin e OE “CETKOS L.L.C; Utal Spz.o.o”, pasi që i njëjti është OE i përgjegjshëm.

Grupi i OE “G.S.G SH.P.K; KIG d.d”, janë të përgjegjshëm për këto dy arsye të eliminimit të cilat edhe AK-ja i ka cekur në letrën standarde dhe ne pajtohemi me arsyetimin e saj si më poshtë:

Ju nuk keni dorëzuar dëshmi siç është kërkuar në aneksin 1 të dosjes së tenderit pika 10 përveç tjerave është kërkuar edhe Shtresë me stampim të nxehtë e cila duhet të dëshmohet me:

Certifikata dhe test raporti i adresuar në prodhuesin e tabelës së regjistrimit në pajtim me standardet ISO 7591 i lëshuar nga një laborator i akredituar, për këtë kërkesë OE ka prezantuar një test raport nga ZAG me numër 47/23-461-3-EN, pas shikimit dhe ekzaminimit të dokumenti shihet se në dokument është bërë vetëm një përshkrim që i referohet një test raporti të vitit 2018 i cili test raport nuk është në përputhje me kërkesat në dosje të tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023. dhe si i tillë nuk mund të pranohet për arsye se është me i vjetër se 36 muaj nga data e njoftimit për kontratë sipas sqarimeve të datës 05.01.2023.

Ju nuk keni dorëzuar një mostër të targës me numër 01 444 AD, ndërsa kërkesa sipas dizajnit grafik skica 01 dhe sqarimeve të datës 05.01.2023 mostra duhet të dorëzohet sipas dizajnit grafik skica 01 e ngarkuar në platformën e prokurimit që është 01 999 AD, andaj rrjedhimisht mostra nuk është dorëzuar sipas kërkesës së AK-MPB.

Ashtu siç e cekëm edhe më lartë ne pajtohem me arsyet e lartcekura për eliminimin e grupit të OE të lartcekur, pasi që të njëjtit janë të papërgjegjshëm.

Grupi i OE “TSR SH.P.K.; EHA Hoffmann International GmbH”, janë të papërgjegjshëm, pasi që edhe ky grup i operatorëve ekonomik nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me Test raportin nga laborator apo instituti i autorizuar. Sa i përket mos plotësimit të kësaj kërkesë nga ana e OE të lartcekur, AK-ja tek letra standarde e ka cekur si në vijim:

Dëshmia qe NUK keni ofruar:

1. Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një test report nga MOTOR TRANSPORT INSTITUT me numër 1050/CBM/20222 datës 05.01.2023.

Ne aneksin 1 te dosjes se tenderit pika 10 përveç tjerave është kërkuar:

Alumin	Raport testues adresuar në prodhuesin e tabelës në pajtim me standardin ISO 7591 nga laborator i akredituar.	Rezultati pozitivë në pajtim me ISO 7591 Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42, shtresa mbrapa aluminit të targës të jetë e mbrojtur me llak transparent.
--------	--	--

Ne test raportin e dorëzuar nga MOTOR TRANSPORT INSTITUT me numër 1050/CBM/20222 datës 05.01.2023 nuk ka evidence te testimi dhe rezultat pozitivë në pajtim me ISO 7591 për Alumin EN AW 1050 H42 ose EN AW 1200 H42 dhe rrjedhimisht nuk është në pajtueshmëri me kërkesën ne aneksin 1 te dosjes se tenderit pika 10 tek specifikat teknike , çdo dokument tjetër i dorëzuar qe nuk është nga laborator i akredituar nuk pranohet, andaj kjo ofertë nuk kalon ne vlerësim te mëtutjeshëm.

Ne pajtohem me arsyen e lartcekur nga ana e AK-së, për eliminimin e grupit të OE “TSR SH.P.K.; EHA Hoffmann International GmbH”, pasi që të njëjtit sipas fakteve te lartcekura janë të papërgjegjshëm.

Grupi i OE “MALSIJAJ COMPANY SHPK; Tonnjes C.A.R.D. International GmbH”, janë po ashtu të papërgjegjshëm, pasi që edhe ky grup si shumica e OE të tjerë nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me Test raportin nga laborator apo instituti i autorizuar.

AK-ja në lidhje me mos plotësimin e kësaj kërkesë nga OE i lartcekur ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Ju për këtë kërkesë keni prezantuar një test raport me numër 6672/CBM/2015 I datës 28.01.2016, ky test raport nuk mund te pranohet për arsyeje se është me i vjetër se 36 muaj nga data e njoftimit për kontratë sipas sqarimeve te datës 05.01.2023, kurse test raporti tjetër qe keni prezantuar nga Dekra me numër 07662022-1 i datës 02.11.2021, nuk ka të evidentuar qe janë bërë matjet (testimet) për mostrën 01-999-AD siç është kërkuar ne dosje te tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023 andaj ky test raport nuk i plotëson kërkesat e dosjes se tenderit dhe sqarimet e datës 05.01.2023.

Ne pajtohem tërësisht me arsyen e lartcekur për eliminimin e grupit të OE “MALSIJAJ COMPANY SHPK; Tonnjes C.A.R.D. International GmbH”.

Ne me dt.21.03.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cekur se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar, mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret në lidhje me refuzimin e saj.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, vetëm e ka përsëritur arsyen e njëjtë sikurse me rastin e eliminimit tonë përmes letrës standarde. E njëjta vetëm i ka përshkruar dispozitat ligjore të cilat ne kemi pretenduar se janë shkelur dhe e ka cekur se të njëjtat janë respektuar dhe pretendimet tona nuk qëndrojnë. Në lidhje me pretendimet tona ankimore përkitazi me arsyen e eliminimit AK-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim konkret se përse nuk qëndron pretendimi ynë ankimor, por vetëm e ka përshkruar arsyen e eliminimit.

Nga ky fakt kuptohet se AK-ja nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, prandaj në mungesë të fakteve dhe argumenteve për tu mbështetur në dispozita ligjore, vetëm e ka përsëritur arsyen e eliminimit. Me këtë veprim AK-ja edhe njëherë po e shfaq diskriminimin që po i bën kompanisë tonë si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Në lidhje me pretendimin tonë ankimor se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 60 dhe 62 të LPP-së, ku AK-ja e ka cekur se ka vepruar në pajtueshmëri e nenin 60 dhe 62 pika 1.1 të LPP-së, sa i përket anulimit të procedurës, sepse nuk është pranuar asnjë tender i përgjegjshëm, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar. Sipas sqarimeve të prezantuara më lartë vërtetohet fakti se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura, pasi që ne jemi OE i përgjegjshëm dhe ky fakt vërtetohet nga dëshmitë e lartcekura.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tona ankimore kundrejt OE të tjerë ne vetëm e kemi cekur se pajtohemi me arsyet e eliminimit të njëjtëve sipas pretendimeve të cilat i kemi parashtruar më lartë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, i pa mbështetur në dispozita ligjore konkrete, por është vetëm një veprim diskriminues kundrejt neve si OE i përgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së**, e që në këtë rast ne duhet të jemi fitues i kësaj kontrate.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet e lartcekura, rezulton se AK-ja e ka anuluar pa bazë këtë aktivitet të prokurimit dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Në këtë tender, ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenet 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse asnjëri nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur në këtë rast dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në këtë fazë dhe në këtë mënyrë.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke mos na rekomanduar për kontratë neve si OE i përgjegjshëm. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

AK është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

V E N D I M

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE EGO ELSA SH.P.K.&RADE KONCAR-KONTAKTORI I RELEI DOO SKOPJE si dhe të **ANULOHET**, njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe të respektohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshtet mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet e përafërta deri më tani janë rreth 40,000.00 euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*